

**UDHËZIM**  
**Nr. 14, datë 17.6.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE TË MËNYRËS SË  
APLIKIMIT PËR SHNDËRRIMIN E LEJEVE MINERARE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Aplikimet për shndërrimin e një lejeje minerare kërkim-zbulimi në një leje shfrytëzimi realizohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Dokumentacioni i plotë i aplikimit për një leje minerare shfrytëzimi, nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të kërkim-zbulimit, paraqitet në QKB. Data e aplikimit të dokumentacionit të plotë është data e përlogaritjes së afatit për miratimin e heshtur.

3. Përmbajtja e dokumentacionit të plotë të aplikimit, procedurat e shqyrtimit dhe e miratimit të tij janë të njëjta me ato kërkesa që aplikojnë subjektet për marrjen e një lejeje minerare në zonat e hapura. Ky dokumentacion duhet të përmbajë dhe vlerësimin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, për realizimin e detyrimeve të lejes së kërkim-zbulimit.

4. Të gjitha subjekteve, që në përputhje me ndryshimet e legjislacionit mineral, kanë aplikuar për shndërrimin e lejes minerare para miratimit të këtij udhëzimi, do t’u vlerësohet kërkesa, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij udhëzimi.

5. Për rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, për zonën e lejuar minerare për të cilën kërkohet shndërrimi i tipit të lejes, kërkuesi ka të drejtën ekskluzive për plotësimin e dokumentacionit përkatës për këtë zonë, sipas afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

6. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Belinda Balluku**